

## Mbi raportet e monitorimit për periudhën Janar - Shtator 2012

Në mbështetje të ligjit nr.10487, datë 05.12.2011 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2012" si dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.2. datë 06.02.2012 "Për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2012", mbi - Raportet e Monitorimit, paraqesim performancën e produkteve të buxhetit për Pushtetin Gjyqësor sipas programeve buxhetore të miratuara për vitin 2012, për periudhën Janar - Shtator 2012.

### **Programi - "Buxheti Gjyqësor"**

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) së hartuar gjatë procesit të PBA 2012-2014. Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP; përmiresimit tërësor të infrastrukturës gjyqësore në funksion të zhvillimit të proceseve gjyqësore dhe rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj publikut. Kjo politikë ka si qëllim kryesor, funksionimin e një pushteti gjyqësor të pavarur, të përgjegjshëm dhe transparent, me qëllim realizimin e shërbimit të dhënies së drejtësisë në vend dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në paanësinë e vendimeve gjyqësore, duke synuar arritjen e standarteve bashkëkohore Europiane.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

### **Formati nr. 6 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën Janar - Shtator 2012.**

Me Ligjin Nr. 10487, datë 05.12.2011 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2012", fondet e akorduara për funksionimin e aktivitetit të gjykatave, sipas artikujve, paraqiten si më poshtë:

#### **1-Shpenzime Personeli**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën Janar - Shtator për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 986,100 mijë lekë. Buxheti i rishikuar është 986,465 mijë lekë dhe realizimi paraqitet në masën 879,409 mijë lekë ose 89% e buxhetit të rishikuar dhe të detajuar. Në realizimin në masën 89% të fondit për paga dhe sigurime shoqërore kanë ndikuar keto faktorë:

Gjatë periudhës Janar - Qershor, ka patur mosplotësime të strukturave organike në disa gjykata si: Gjykata e Lartë, Gjykatat e Apeleve Durrës, Gjirokastrë, Shkodër, Tiranë, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Diber, Elbasan, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Laç, Lezhë, Lushnjë, Mat, Pukë, Sarandë, Shkodër, Tropojë edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor për Krimet e Rënda.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është detajuar sipas strukturës organike të plotë të gjyqtarëve, të përcaktuar me dekret të Presidentit. Ndërkohë që, gjatë kësaj periudhe nuk janë

emëruar të gjithë gjyqtarët, sipas strukturave të miratuara. Për periudhën Janar - Shtator nuk janë plotësuar vendet vakante për 37 gjyqtarë. Në këtë mënyrë nuk është përdorur i plotë fondi i detajuar për pagesën e gjyqtarëve për këtë periudhë.

Gjithashtu Ministria e Financave, deri në këtë moment, nuk ka miratuar detajimin e numrit shtesë të punonjësve për vitin 2012, duke mos bërë efektive strukturat e reja organike të gjykatave.

## **2-Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën Janar - Shtator është 219,480 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 221,893 mijë lekë (kjo rritje vjen për shkak të akordimit nga Ministria e Financave, të fondit të vecantë të përdorur nga gjykatat gjatë kësaj periudhe). Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 213,902 mijë lekë ose 97% e buxhetit të rishikuar, si dhe 96% e buxhetit të detajuar në fillim të vitit.

Procedurat për prokurimin e fondeve të planifikuara për disa gjykata në këtë periudhë për tonera, karburant, goma, ruajtjen e godinave të gjykatave, etj. për gjykatat pothuajse kane përfunduar, duke ndikuar kështu në performancën e shpenzimeve operative për 9/mujorin. Në këtë këndvështrim, pjesa më e madhe e gjykatave kanë arritur të realizojnë përdorimin e plotë të fondeve të planifikuara sikurse: Gjkata e Lartë, Gjkata e Apelit Tiranë, Vlorë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Laç etj.

Pavarësisht masës së realizimit të shpenzimeve operative për 9/mujorin, shpjegojmë se buxheti i miratuar për vitin 2012, është i pamjaftueshëm për mbështetjen e plotë të aktivitetit të gjykatave, deri në fund të vitit. Buxheti i miratuar për vitin 2012, prej 282 milion lekë, jo vetëm që nuk plotëson të gjithë nevojat e parashtruara nga gjykatat, por është rreth 18 milion lekë më i ulët se buxheti efektiv për vitin 2011. Ndërkohë që për vitin 2011, gjykatat rezultuan me detyrime të papaguara, të pasqyruara në bilancet e tyre vjetore, në vlerë rreth 20 milion lekë, duke e rënduar më tepër situatën buxhetore për shpenzime operative për vitin 2012.

Nga analizat dhe monitorimi në vazhdimësi i shpenzimeve operative të kryera nga gjykatat si dhe vetë kërkesat e paraqitura prej tyre, rezulton se buxheti i mbetur në dispozicion deri në fund të vitit, nuk mbulon të plotë nevojat e gjykatave për zëra kryesore të shpenzimeve si: energji elektrike, ujë, shërbim postar, shpenzime për dieta të gjyqtarëve të komanduar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, shpenzime për ruajtjen e godinave të gjykatave, shpenzime për avokatë të thirrur kryesisht etj. Me gjithë masat e marra për menaxhimin e buxhetit, duke u fokusuar në plotësimin e nevojave më prioritare të gjykatave, buxheti për pjesën e mbetur të vitit, vë në diskutim aktivitetin e tyre dhe përmbushjen e shërbimeve gjyqësore për periudhën Tetor- Dhjetor 2012.

## **3-Investime**

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit, për periudhën Janar - Shtator është 179,500 mijë lekë dhe realizimi 113,303 mijë lekë ose 63% .

**në mijë/lekë**

<b>Projekti</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>%</b>
-----------------	-------------	-------------	----------

1 Rikonstruksion	96,580	50,835	53%
2 Pajisje - Mobilje	64,270	46,551	73%
3 Projekt	8,650	5,953	69%
4 Automjete	10,000	9,964	100%
<b>TOTALI</b>	<b>179,500</b>	<b>113,303</b>	<b>63%</b>

## “Rikonstruksion”

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit në “Rikonstruksion” për periudhën Janar-Shtator është 96,580 mijë lekë dhe realizimi 50,835 mije lekë, ose 53%. Ky fond është planifikuar të realizohet në 10 gjykata. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Mat, Kavajë dhe Vlorë kanë përfundur plotësisht prokurimin dhe likuidimin, për fondet e vëna në dispozicion për vitin 2012. Ndërsa për gjykatat e tjera situata paraqitet si më poshtë:

- Për Gjykatën e Rrethit të Rrethit Gjyqësor Pogradec, është detajuar fondi në masën 31,000 mije lekë, kurse realizimi është 20,312 mije lekë, ose 66%. Gjykata ndërpreu përkohësisht punimet në fillim të vitit për rikonstruksionin e plotë të godinës të gjykatës, për shkak të kushteve të papërshtatëshme atmosferike (ngrica). Në muajin Mars rifilloi punimet me intesitet me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Vazhdojnë punimet dhe njëkohësisht edhe likuidimi i tyre sipas situacioneve të paraqitura. Punimet për fazën e dyte dhe njëkohësisht rikonstruksioni i plotë i godinës së ish-Shtëpisë së Oficerave për gjykatën, parashikohet të përfundojnë në muajin Tetor.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve për përshtatjen e godinës së ish-Institutit të Kërkimeve Zooteknike në godinë të Dhomës Administrative të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Vlera e plotë e kësaj kontrate është rreth 58,000 mijë lekë. Financimi i këtij objekti është parashikuar të shtrihet në dy vite 2012-2013. Fondi i detajuar për këtë qëllim për vitin 2012 është 35,000 mijë lekë. Kanë filluar punimet për rikonstruksionin e godinës dhe deri tani është likuiduar vlera 16,533 mijë lekë.
- Për Gjykatën e Apelit Tiranë, kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve për rikonstruksion të ambjentëve ekzistuese të gjykatës, me qëllim akomodimin e gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Dhomës Administrative të kësaj gjykate. Vlera e plotë e kontratës është rreth rreth 17,000 mijë lekë. Financimi i këtij objekti është parashikuar të shtrihet në dy vite 2012-2013. Fondi i detajuar për këtë qëllim për vitin 2012 është 10,000 mijë lekë. Kanë përfunduar punimet dhe likuidimi për rikonstruksionin e godinës.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, është detajuar fondi në masën 9,000 në mije lekë për rikonstruksionin e plotë të godinës. Gjykata ka filluar punimet dhe është në proces. Rikonstruksioni i godinës së gjykatës është parashikuar të shtrihet në dy vite 2012-2013.

- Në këtë projekt është detajuar edhe fondi prej 4,000 mijë lekë për rikonstrukcion të rrjetit elektrik si dhe disa punime plotësuese në nivel mirëmbajtje të godinës së Gjykatës të Lartë. Gjykata ka përfunduar punimet dhe pritet të kryeje likuidimin.
- Për Gjykatën e Apelit Korçë është detajuar një fond në masën 1,080 mijë lekë për rikonstrukcion në nivel mirëmbajtje. Gjykata ka anuluar tenderin e parë për mungesë konkurrence dhe ka nisur procedurat për përsëritjen për herë të dytë.
- Për Gjykatën e Apelit Vlorë është detajuar fond në masën 480 në mijë lekë, për disa ndërhyrje të vogla në murin e jashtëm të godinës si dhe vendosjen e një porte në rrethimin e jashtëm të objektit. Gjykata ka filluar punimet është në perfundim të tyre.

## "Paisje Mobilje"

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit për 9/mujorin është 64,270 mijë lekë dhe realizimi 46,551 mijë lekë ose 73%. Ky realizim vjen nga likuidimet që gjykatat kanë kryer për prokurimet më vlerë të vogël, për paisje të ndryshme. Për periudhën 9/mujore situata e investimeve për këtë projekt, sipas grupeve kryesore të pajisjeve, paraqitet si më poshtë:

✚ *Paisje elektronike.* Fondi i akorduar për 9/mujorin është 26,049 mijë lekë, ndërsa realizimi 14,387 mijë lekë ose 69%.

- a) Kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë në proces likuidimi:
  - Gjykata e Apelit Durrës me fondin 1,210 mijë lekë.
  - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me fondin 9,930 mijë lekë,

✚ *Paisje elektrike.* Fondi i akorduar për 9/mujorin është 2,255 mijë lekë, i cili është realizuar i plotë, në masën 100%.

✚ *Paisje sigurie.* Fondi i akorduar për periudhën Janar-Shtator është 6,810 mijë lekë, ndërsa realizimi 6,112 mijë lekë ose 89%.

- a) Ka zhvilluar procedurat e prokurimit, por ka dështuar në realizimin e saj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër me fondin në masën 600 mijë lekë. Gjykata është në proces të rishikimit të procedurës, me qëllim marrjen e një vendimi për përsëritjen e saj.

✚ *Mobilje .* Fondi i akorduar për 9/mujorin është 24,729 mijë lekë, ndërsa realizimi është në masën 20,715mijë lekë, ose 84% .

- a) Ka nxjerre Urdherin e Prokurimit dhe është në proces prokurimi për blerje me vlera të vogla, Gjykata e Lartë me fondin në masën 100 mijë lekë.

✚ *Paisje të tjera.* Fondi i akorduar për 9/mujorin është 4,427 mijë lekë, ndërsa realizimi është 3,069 mijë lekë ose 73%.

- a) Ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është në proces likuidimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me fondin 650 mijë lekë.

- b) Ka nxjerre Urdherin e Prokurimit dhe është në proces prokurimi për blerje me vlera të vogla, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korce, me fondin 75 mijë lekë.

## "Projekt".

✚ Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për këtë zë të investimeve është 8,650 mijë lekë, ndërsa realizimi është 5,953 mijë lekë ose 69%.

Për periudhën 9/mujore është detajuar fond për hartimin e projekteve për rikonstrukcion të plote për 7 godina gjykatash.

- Për Gjykatën e Apelit Tiranë është detajuar një fond 480 mijë lekë për hartimin e projektit për krijimin e ambienteve për akomodimin e gjyqtareve të Dhomës Administrative të Gjykatës së Apelit Tiranë. Këto ambiente do të krijohen duke bërë përmirësime dhe plotësime të ambienteve ekzistuese të gjykatës. Për këtë projekt ka përfunduar prokurimi dhe likuidimi i tij
- Për Gjykatën e Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, nevojitet realizimi i disa rregullimeve për përmirësim të ambienteve të brendshme dhe riorganizim të skemës funksionale të godinës së gjykatës. Për këtë ishte i domosdoshëm hartimi i një projekti, i cili do të mund të jepte zgjidhjet teknike, për përmirësimin e gjendjes së kësaj gjykate. Fondi i detajuar për realizimin e projektit, është 480 mijë lekë. Gjykata ka përfunduar prokurimin edhe likuidimin.
- Për Gjykatën e Lartë, pas rialokimeve të kryera, është detajuar një fond 270 mijë lekë për hartimin e projektit, në funksion të rikonstrukcionit të rrjetit elektrik të godinës. Edhe kjo gjykatë ka përfunduar prokurimin edhe likuidimin e fondit të miratuar.
- Për Gjykatën e Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është detajuar një fond 2,100 mijë lekë për hartimin e projektit për rikonstrukcion të plotë të godinës së gjykatës. Për këtë projekt ka përfunduar prokurimi dhe likuidimi i tij.
- Gjatë vitit 2011 është kryer nga Z.A.B.GJ, projekti për rikonstrukcionin e godinës së ish-Institutit Zooteknik Tiranë për Dhomën Administrative të kësaj gjykate. Pjesa e fondit të miratuar për vitin 2011 nuk u realizua, për arsye të bllokimit pa asnjë argument nga Dega e Thesarit, të dokumentacionit të paraqitur. Për vitin 2012, u detajua 40% e vlerës sipas parashikimit në VKM nr.444, ku përcaktohet se me dorëzimin e projektit, paguhet vetëm 60% e vlerës totale të shërbimit, ndërsa pjesa tjetër prej 40%, duhet të paguhet mbas prokurimit të zbatimit, ose mbasi është mbushur një vit nga dorëzimi i projektit. Si rezultat i rialokimit të fondeve në muajin Gusht, është bërë e mundur likuidimi i plotë në vlerën 3,474 mijë lekë.
- Për Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Fier dhe Lezhë, nuk janë realizuar procedurat e prokurimit për fondet e detajuara.

-Përsa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, deri në këtë moment, nuk kanë arritur të përfundojnë procedurat administrative lidhur me miratimin e sheshit të ndërtimit, e për pasojë nuk ka mundur të fillojnë procedurat për prokurimin e fondit të akorduar për hartim projekti. Meqënëse gjatë këtij viti nuk do të hartohet projekti për ndërtim godine

të re, gjykata do të prokurojë një pjesë të këtij fondi për të plotësuar një nevojë imediate për krijimin e ambjentit të mardhënies me publikun. Ky ambjent i mungon gjykatës dhe aktualisht shërbimi i publikut kryhet nëpërmjet dritares së kryesekretarisë.

-Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë në fillim të vitit u detajua fond për hartimin e projektit për ndërtim shtese godine të gjykatës, për shkak të pamjaftueshmërisë së ambjenteve të punës në të. Gjkata ka nevojë për shtim të sallave të gjyqit, pasi numri i sallave që ka aktualisht, nuk lejon realizimin e gjithë proceseve gjyqësore në salla gjyqi. Gjkata është në proces të vlerësimit të sheshit topografik, pasi terreni ku mendohet të kryhet ndërtimi paraqet probleme rrëshqitjeje. Në këtë mënyrë, deri në gjetjen e një zgjidhje të përshtatshme për kryerjen e investimit, nuk mund të fillojnë procedurat për hartimin e projektit për këtë gjykatë.

Një pjese e fondit të detajuar në fillim të vitit për këto gjykata është alokuar për mbylljen e detyrimit të mbartur nga viti 2011 për likuidimin e projektit për Dhomën Administrative të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Pjesa e mbetur është rialokuar në muajin Tetor, për të plotësuar nevoja të tjera imediate që gjykatat kanë në investime.

### **“Automjet”**

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit në “ Automjet” për periudhën Janar-Shtator është 10,000 mijë lekë dhe realizimi 9,964 mijë lekë, ose 100%. Ky fond u planifikua dhe përdor u për blerjen e tre autovecurave për nevoja të gjykatave.

### **Formati nr.7 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve**

Buxheti i detajuar për periudhën Janar- Shtator 2012, në fillim të vitit për këtë program është 1,385,080 mijë lekë dhe realizimi 1,207,454 mijë lekë ose 87 %. Në këtë realizim kanë ndikuar disa faktorë:

-Gjatë periudhës Janar - Shtator, ka patur mosplotësime të strukturave organike në disa gjykata si: Gjykata e Lartë, Gjykatat e Apeleve Durrës, Gjirokastrë, Shkodër, Tiranë, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Diber, Elbasan, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Laç, Lezhë, Lushnjë, Mat, Pukë, Sarandë, Shkodër, Tropojë edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor për Krimet e Rënda.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është detajuar sipas strukturës organike të plotë të gjyqtarëve, të përcaktuar me dekret të Presidentit. Ndërkohë që, gjatë kësaj periudhe nuk janë emëruar të gjithë gjyqtarët, sipas strukturave të miratuara. Për periudhën Janar - Qershor nuk janë plotësuar vendet vakante për 37 gjyqtarë. Në këtë mënyrë nuk është përdorur i plotë fondi i detajuar për pagesën e gjyqtarëve për këtë periudhë.

Gjithashtu Ministria e Financave deri në këtë moment, nuk ka miratuar detajimin e numrit shtesë të punonjësve për vitin 2012, duke mos bërë efektive strukturat e reja organike të gjykatave.

- Procedurat për prokurimin e fondeve të planifikuara për disa gjykata në këtë periudhë për tonera, karburant, goma, ruajtjen e godinave të gjykatave, etj. për gjykatat pothuajse kanë përfunduar, duke ndikuar kështu në performancën e shpenzimeve operative për

9/mujorin. Ne këtë këndvështrim, pjesa më e madhe e gjykatave kanë arritur të realizojnë përdorimin e plotë të fondeve të planifikuara sikurse: Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit Tiranë, Vlorë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Laç etj.

- Përsa i përket fondit të investimeve, gjykatat janë në proces të përfundimit të procedurave të prokurimit për fondet e detajuara për këtë periudhë.

## **Formati nr.8 - Raporti i Realizimit të Produkteve të Programit**

Programi “Buxheti Gjyqësor” për periudhën Janar - Shtator 2012 përbëhet nga disa produkte, të cilat janë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Në funksion të objektivit të parë të DPP-se, janë përcaktuar disa produkte, realizimi sasior i të cilëve paraqitet si më poshtë:

**Produkti A** “Çeshtje të gjykuara në vit”- Njësia matëse nr. çështjesh.

Numri i çështjeve të parashikuara për periudhën Janar - Shtator 2012 është 102,847 dhe realizimi 104,207 çeshtje të gjykuara plotësisht. Nga nje këndvështrim i përgjithshëm, vihet re një tejkalim i çështjeve të parashikuara për t’u gjykuar, kjo për shkak të rritjes se numrit të çështjeve ndaj CEZ-Shperndarje. Duhet të theksojme se në planifikimin e numrit të çështjeve për periudhën Janar - Shtator 2012, realizuar gjatë procesit të hartimit të kërkesave buxhetore për vitin 2011, nuk janë marrë në konsideratë çeshtjet që kanë të bëjnë me lëshimin e urdherave të ekzekutimit nga CEZ-Shperndarje për faktin se nuk ka ekzistuar kjo dukuri (ekzekutimet e CEZ).

**Produkti C-** “Projekt zbatim për godina të reja”. Njësia matëse nr. institucioni.

Në këtë produkt është parashikuar projekt për zbatim për godinë të re për nje gjykate dhe konkretisht Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Nuk është realizuar aspak ky produkt. Fondi i detajuar për këtë qëllim, u rialokua për mbylljen e detyrimit nga viti 2011, për projektin e Dhomës Administrative të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

**Produkti D** - “Projekt zbatim për rikonstruksion të plotë të godinave të gjykatave”. Njësia matëse nr. institucioni.

Në këtë produkt është parashikuar projekt për rikonstruksion të plotë në 6 institucione dhe konkretisht është realizuar:

- a) Plotësisht në 5 gjykata. Këtu bën pjesë edhe Gjykata e Lartë, e cila e ka realizuar këtë produkt nëpërmjet rialokimit të fondeve.
- b) Apak në 2 gjykata dhe konkretisht Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Lezhë. Fondi i detajuar për këtë qëllim, është rialokuar në muajin Tetor për nevoja të tjera emergjente të gjykatave në investime.

**Produkti E-** “Sipërfaqe godine e rikonstruktuar” - Njësia matëse m<sup>2</sup>.

Në këtë produkt për periudhën Janar - Shtator është parashikuar të realizohet 630 m<sup>2</sup> siperfaqe godine e rikostruktuar plotësisht dhe është realizuar 350 m<sup>2</sup> në terma sasiorë. Ky parashikim ka të bëjë me rikonstrukcionin e plotë për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Gjykata ndërpreu përkohësisht punimet në fillim të vitit për rikonstrukcionin e plotë të godinës të gjykatës, për shkak të kushteve të papërshtatëshme atmosferike (ngrica). Në muajin Mars rifilloi punimet me intesitet me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Vazhdojnë punimet dhe njëkohësisht edhe likuidimi i tyre sipas situacioneve të paraqitura.

**Produkti F** “Mobilje për zyra dhe salla gjyqi për gjykatat ” - Njësia matëse nr. institucioni.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i mobiljeve për zyra dhe salla gjyqi, për 13 institucione dhe konkretisht është realizuar:

- a) Plotësisht në 14 gjykata. Dy gjykata e kanë realizuar plotësisht këtë produkt me ndryshim në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.
- b) Pjesërisht 1 gjykatë.

**Produkti G** -“Elementë sigurie për gjykatat”- Njësia matëse nr. institucioni.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i elementëve të sigurisë për 10 institucione. Konkretisht është realizuar:

- a) Plotësisht në 10 gjykata. Një gjykatë e ka realizuar plotësisht këtë produkt me ndryshim në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.
- b) Apak 1 gjykatë.

**Produkti H** -“Paisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave”- Njësia matëse nr. Institucioni.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i paisjeve të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatës në 17 institucione dhe është realizuar:

- a) Plotësisht në 15 gjykata.
- b) Pjesërisht në 2 gjykata.

**Produkti I** -“Automjete për gjykatat”- Njësia matëse nr. automjete

Në këtë produkt është parashikuar blerja e tre autovecurave për nevoja të gjykatave. Ky produkt është realizuar plotësisht.

Në funksion të objektivit të dytë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, realizimi sasior i të cilit paraqitet si më poshtë:

**Produkti J** -“Paisje elektronike për gjykatat” -Njësia matëse për këtë produkt “nr.institucioni”.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i pajisjeve elektronike për 24 institucioni ku është realizuar:



- a) Plotësisht në 22 gjykata.
- b) Pjesërisht në 2 gjykata.

Në funksion të objektivit të tretë të DPP-se, janë përcaktuar 2 produkte, realizimi sasior i tyre paraqitet si më poshtë:

**Produkti K** - “Gjyqtare të trajnuar për anën profesionale të tyre” - Njësia matëse nr.gjytaresh.

Në këtë produkt është parashikuar mbështetja me buxhet për shpenzimet në udhëtim e dieta për trajnimin profesional të 95 gjyqtarëve nga Shkolla e Magjistratures, ndërkohe që janë realizuar trajnimë për 79 gjyqtarë. Për këtë produkt shpjegojmë se trajnimet janë kryer nga Shkolla e Magjistratures, në baze të detyrimit ligjor që ka ky institucion.

### **Formati nr.9 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produkteve**

Programi i parë “Buxheti Gjyqësor” për periudhën Janar - Shtator 2012 përbehet nga disa produkte të cilat janë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Në funksion të objektivit të parë të DPP-se, janë përcaktuar disa produkte, realizimi vleror i të cileve paraqitet si më poshtë:

**Produkti A** - “Çështje të gjykuara në vit”. Buxheti për këtë produkt për periudhën Janar – Shtator 2012, është planifikuar në shumën 1,202,835 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,091,457 mijë lekë ose 91%.

Në këtë realizim kanë ndikuar disa faktorë:

Gjatë periudhës Janar - Shtator, ka patur mosplotësime të strukturave organike në disa gjykata si: Gjykata e Lartë, Gjykatat e Apeleve Durrës, Gjirokastër, Shkodër, Tiranë, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Diber, Elbasan, Gjirokastër, Kavajë, Korçë, Krujë, Laç, Lezhë, Lushnjë, Mat, Pukë, Sarandë, Shkodër, Tropojë edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor për Krimet e Rënda.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është detajuar sipas strukturës organike të plotë të gjyqtarëve, të përcaktuar me dekret të Presidentit. Ndërkohë që, gjatë kësaj periudhe nuk janë emëruar të gjithë gjyqtarët, sipas strukturave të miratuara. Për periudhën Janar - Qershor nuk janë plotësuar vendet vakante për 37 gjyqtarë. Në këtë mënyrë nuk është përdorur i plotë fondi i detajuar për pagesën e gjyqtarëve për këtë periudhë.

Gjithashtu Ministria e Financave deri në këtë moment, nuk ka miratuar detajimin e numrit shtesë të punonjësve për vitin 2012, duke mos bërë efektive strukturat e reja organike të gjykatave.

**Produkti C**- “Projekt zbatim për godina të reja ”. Buxheti për këtë produkt për periudhën Janar-Shtator është 1,740 mijë lek.

Në këtë produkt është parashikuar projekt zbatim për godinë të re në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Nuk është realizuar ky produkt, pasi nuk janë realizuar procedurat e prokurimit për fondet e detajuara, për shkak të nevojës për qartësim të idesë së ndërtimit të një godine të re për gjykatën si dhe nevojës emergjente që u paraqit për mbylljen e detyrimit për hartimin e projektit për Dhomën Administrative të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

## **Produkti D** - “Projekt zbatim për rikonstrukcion të plotë të godinave të gjykatave”.

Buxheti për këtë produkt është 6,640 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 5,953 në mijë, ose 90%. Në këtë produkt është përfshirë fond për hartimin e projekteve për rikonstrukcion të plotë për 6 gjykatadhe është realizuar për Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit Tirane, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjirokastër dhe ZABGJ-në. Në 2 gjykatat e tjera situata paraqitet si më poshtë:

- Përsa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, deri në këtë moment, nuk kanë arritur të përfundojnë procedurat administrative lidhur me miratimin e sheshit të ndërtimit, e për pasojë nuk ka mundur të fillojnë procedurat për prokurimin e fondit të akorduar për hartim projekti. Meqënëse gjatë këtij viti nuk do të hartohet projekti për ndërtim godine të re, gjykata do të prokurojë një pjesë të këtij fondi për të plotësuar një nevojë imediate për krijimin e ambjentit të mardhënieve me publikun. Ky ambjent i mungon gjykatës dhe aktualisht shërbimi i publikut kryhet nëpërmjet dritares së kryesekretarisë.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë në fillim të vitit u detajua fond për hartimin e projektit për ndërtim shtese godine të gjykatës, për shkak të pamjaftueshmërisë së ambjenteve të punës në të. Gjykata ka nevojë për shtim të sallave të gjyqit, pasi numri i sallave që ka aktualisht, nuk lejon realizimin e gjithë proceseve gjyqësore në salla gjyqi. Gjykata është në proces të vlerësimit të sheshit topografik, pasi terreni ku mendohet të kryhet ndërtimi paraqet probleme rrëshqitjeje. Në këtë mënyrë, deri në gjetjen e një zgjidhje të përshtatshme për kryerjen e investimit, nuk mund të fillojnë procedurat për hartimin e projektit për këtë gjykatë.

Një pjese e fondit të detajuar në fillim të vitit për këto gjykata është alokuar për mbylljen e detyrimit të mbartur nga viti 2011, për likuidimin e projektit për Dhomën Administrative të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Pjesa e mbetur është rialokuar në muajin Tetor, për të plotësuar nevoja të tjera imediate që gjykatat kanë në investime.

**Produkti E**- “Sipërfaqë godinë e rikonstruktuar” - Buxheti për këtë produkt për periudhën Janar-Shtator është 93,380 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 50,835 mijë lekë, ose 54%. Për këtë produkt gjykatat janë në proces për të përfunduar prokurimet, konkretisht:

- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, u detajua fondi në masën 3,000 në mije lekë, për përfundimin e likuidimit të supervisorit dhe kolaudatorit, në vijim të kontratës së përfunduar gjatë vitit 2011 për rikonstrukcionin e plotë të godinës. Ka përfunduar likuidimi.
- Për Gjykatën e Apelit Tiranë, u detajua fondi në masën 10,000 në mije lekë, për rikonstrukcionin e pjesshëm të godines të gjykatës. Ka përfunduar prokurimi dhe likuidimi.
- Për Gjykatën e Rrethit e Rrethit Gjyqësor Pogradec, është detajuar fond në masën 31,000 në mije lekë kurse realizimi është 20,312 mije lekë, ose 66%. Gjykata ndërpreu përkohësisht punimet në fillim të vitit për rikonstrukcionin e plotë të godinës të gjykatës, për shkak të kushteve të papërshtatshme atmosferike (ngrica). Në muajin Mars rifilloi punimet me intesitet me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Vazhdojnë punimet dhe njëkohësisht edhe likuidimi i tyre sipas situacioneve të paraqitura.

- Për Gjykatën e Lartë është detajuar fondi në masën 800 në mije lekë për rikonstrukcion të rrjetit elektrik si dhe disa punime plotësuese në nivel mirëmbajtje të godinës së gjykatës. Kanë përfunduar punimet dhe është në proces likuidimi.
- Për Gjykatën e Apelit Vlorë është detajuar fond në masën 480 në mije lekë. Gjykata ka filluar punimet dhe është në perfundim te tyre.
- Për ZABGJ, në fillim të vitit është detajuar një fond në masën 35,000 në mije lekë, për përshtatjen e godinës së ish-Institutit të Kërkimeve Zooteknike në godinë të Dhomës Administrative të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Ky fond është rialokuar për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe ka filluar punimet. Po vazhdojnë punimet dhe njëkohësisht edhe likuidimi i tyre sipas situacioneve të paraqitura.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë për fondin e detajuar për të vlerën 2,700 në mijë lekë, ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe likuidimit.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, është detajuar fondi në masën 9,000 në mije lekë për rikonstrukcionin e plotë të godinës. Gjykata ka filluar punimet dhe është në proces.
- Për Gjykatën e Apelit Korçë është detajuar një fond në masën 1,080 mijë lekë për rikonstrukcion në nivel mirëmbajtje. Gjykata ka anuluar tenderin e parë për mungesë konkurrence dhe do ta përsërisë për herën e dytë.

**Produkti F-** “Mobilje për zyra dhe salla gjyqi për gjykatat ”. Buxheti për këtë produkt është 25,205 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 20,715 mijë lekë ,ose 82%. Nuk është realizuar ky produkt plotësisht vetem nga Gjykata e Lartë e cila me fondin në masën 100 mijë lekë ka nxjerrë Urdhërin e Prokurimit për procedurën blerje me vlerë të vogël dhe është në process.

**Produkti G** -“Elementë sigurie për gjykatat”. Për këtë produkt është parashikuar buxhet për periudhën Janar - Shtator në vlerën 6,330 mijë lekë ndërsa është realizuar 6,112 mijë lekë ose 97%.

- a) Nuk është realizuar ky produkt plotësisht vetem nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër e cila ka zhvilluar procedurat e prokurimit, por ka dështuar në realizimin e saj. Gjykata është në proces të rishikimit të procedurës, me qëllim marrjen e një vendimi për përsëritjen e saj.

**Produkti H** -“Paisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave”. Për këtë produkt është parashikuar buxhet për periudhën Janar - Shtator në vlerën 7,735 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 5,337 mijë lekë, ose 69%. Ky produkt është realizuar në pjesen më të madhe të gjykatave, kurse Gjykatat e Rretheve Gjyqësor Tiranë dhe Korçë janë në proces të prokurimit blerje me vlerë të vogël.

**Produkti I** -“Automjete për gjykatat”- Për këtë produkt është parashikuar buxhet për periudhën Janar - Shtator në vlerën 10,000 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 9,964 mijë lekë, ose 100%. Ky produkt është realizuar plotësisht.

Në funksion të objektivit të dytë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, realizimi vleror i të cilit paraqitet si më poshtë:

**Produkti J** -“Paisje elektronike për gjykatat”. Buxheti për periudhën Janar- Shtator për këtë produkt është 28,470 mijë lekë, ndërsa është realizuar 14,387 mijë lekë ose 51%. Për këtë produkt pjesa më e madhe e gjykatave kanë realizuar procedurat e prokurimit dhe likuidimit për fondet e vëna në dispozicion. Ndërsa Gjykata e Apelit Durrës (1210 mijë lekë) dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (9930 mijë lekë) kanë lidhur kontratat dhe janë në proces likuidimi.

**Produkti K**- “Gjyqtarë të trajnuar për anën profesionale të tyre”. Ky produkt për periudhën Janar- Shtator është parashikuar në masën 2,745 mijë lekë, ndërkohe që është realizuar në vlerën prej 2,694 mijë lekë, ose 98%. Ky produkt është realizuar plotësisht.

### **Programi- “Planifikim menaxhim dhe administrim ”**

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP). Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP; harmonizimi i nevojave të Gjyqësorit me burimet financiare në dispozicion, në funksion të përmirësimit tëresor të infrastrukturës Gjyqësore për realizimin e proceseve Gjyqësore dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut. Kjo politikë ka si qëllim kryesor, menaxhimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore, që miratohen për Pushtetin Gjyqësor për të siguruar pavaresinë financiare të Gjyqësorit .

### **Formati nr. 6 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën Janar-Shtator 2012.**

Me Ligjin Nr. 10487, datë 05.12.2011 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2012", Zyrës të Administrimit të Buxhetit Gjyqësor i janë akorduar fondet, sipas artikujve si më poshtë:

#### **1.Shpenzimë Personeli**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit si dhe buxheti i rishikuar për periudhën Janar-Shtator 2012, për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 13,036 mijë lekë kurse realizimi është 12,225 mijë lekë ose 94% e buxhetit të detajur dhe rishikuar. Ky realizim vjen pasi nuk është përdorur fondi për një punonjës IT, e cili ka qenë me leje lindje, si dhe analisti i shpenzimeve i cili ka ndërprerë mardhëniet e punës në muajin Prill.

#### **2.Shpenzime për Mallra dhe Shërbimë të Tjera**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën Janar-Shtator për vitin 2012 është 3,100 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 3,143 mijë lekë.(kjo rritje vjen për shkak të akordimit nga Ministria e Financave, të fondit të vecantë të përdorur nga gjykatat gjatë kësaj periudhe).

Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 2,985 mijë lekë, ose 96 % ndaj buxhetit të planifikuar, dhe 95%, buxhetit të rishikuar.

### **3.Investime**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën Janar-Shtator është 500 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 348 mijë lekë, ose 70%. Ky program përbëhet nga një projekt “Paisje-Mobilje”. Ky fond u detajua për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për plotësimin e nevojave për pajisje elektronike dhe mobilje për punonjësit e saj. Kanë përfunduar procedurat e prokurimit për plotësimin e nevojave për “Paisje elektronike” dhe “Paisje të tjera”. Është në proces likuidimi për prokurimin e fondit të mbetur në masën 150 mijë në zërin “Mobilje”.

### **Formati nr.7 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve**

Fondi i detajuar për këtë program për periudhën Janar-Shtator 2012, në fillim të vitit është 16,771 mijë lekë dhe realizimi 15,713 mijë lekë ose 94%. Ky program përbëhet vetëm nga një produkt “Buxhet vjetor për Pushtetin Gjyqësor i administruar në mënyre eficiente dhe efektive”. Në funksion të realizimit të këtij produkti shërben i gjithë buxheti i detajuar për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime. Realizimi në këtë përqindje është rrjedhojë e mospërdorimit të plotë të fondit për shpenzime personeli dhe investime për arsyet e sipërpërmendura.